



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 206 prot.

Fushë-Arrëz, më 24. 01. 2025

PROCESVERBAL I DËGJESËS PUBLIKE

Mbi Draftin e Planit të Integritetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025-2027 .

I mbajtur sot, më 24.01.2025.

Vendi: Në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz

Ora:11:00

TEMA: DËGJESË PUBLIKE ”Mbi Draftin e Planit të Integritetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025-2027 ”.

Në takim marrin pjesë:

Hil Curri, Kryetar i Bashkisë Fushë-Arrëz;
Hil Kola, Zëvendëskryetar i Bashkisë Fushë-Arrëz;
Aldi Lepuri, Jurist në Bashkinë Fushë-Arrëz ;
Sidorela Katroshi, Përgjegjëse e Zyrës së Çështjeve Sociale;
Naze Selimaj, Sekretar i Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz.

Të pranishëm në këtë konsultë janë **banorë** të Bashkisë Fushë-Arrëz, anëtarë të Këshillit Bashkiak, drejtues të Kopshtit, QKF-së, Çerdhes së fëmijëve, Kryetarë të fshatrave si dhe drejtues të zyrave specifike dhe punonjës të Administratës së Bashkisë Fushë-Arrëz.

Naze Selimaj, Sekretar i Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz:

Përshendetje të nderuar pjesëmarrës, mirë se keni ardhë! Në mbështetje dhe zbatim të nenit 18 dhe nenit 54 shkronja “k” të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, të ligjt nr.146/2014 për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, të Rregullores së përgjithshme të Këshillit Bashkiak VKB nr. 15, datë 27/04/2020 dhe Rregullores së konsultimeve me publikun të Këshillit Bashkiak VKB nr16, datë 27/04/2020, Këshilli Bashkiak Fushë Arrëz, ka njoftuar kohë më parë zhvillimin e kësaj dëgjese publike për diskutimin e projektvendimit “Mbi Planin e Integritetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025-2027” i cili do të fillojë zbatimin pas miratimit nga Këshilli Bashkiak.

Duke ju falenderuar që jeni sot këtu, ju ftoj të dëgjojmë zyrat përkatëse lidhur me këtë plan dhe më pas mundeni të jepni mendimet dhe sugjerimet tuaja. Për detaje të hollësishme lidhur me këtë plan, fjala për

Aldi Lepuri, Jurist në Bashkinë Fushë-Arrëz:

Njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, përballen me risqe korrupzioni që mund të kenë pasoja negative në përm bushjen e objektivave të synuara. Risku i integritetit është një problem ekzistues për të gjitha nivelet e qeverisjes.

Gjithsesi në vetëqeverisjen vendore ai bëhet edhe më i ndjeshëm duke qenë se bashkitë qeverisin më pranë qytetarëve e si rrjedhojë kontaktet ndërmjet zyrtarëve të qeverisjes vendore dhe publikut janë më të shpeshta, duke rritur kështu dhe mundësitë për shfaqjen e risqeve të të tillë si raste të shfaqjes së konfliktit të interesit, nxjerrje e një informacioni konfidencial apo privat, diskriminim, etj.

Nga ana tjetër bashkitë e vogla përballen me sfida të shtuara për sigurimin e kapaciteteve njerëzore, financiare dhe teknike për përbushjen e funksioneve të tyre me një standard të lartë për qytetarët.

Si rrjedhojë, Bashkia Fushë-Arrëz ka ndërmarrë nismën për miratimin e Planit të Integritetit për periudhën 2025-2027 me qëllim evidentimin dhe vlerësimin e risqeve të integritetit, si dhe hartimin e një plani masash për minimizimin e tyre në një plan afatmesëm.

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Bashkinë Fushë-Arrëz kaloi nëpërmjet vlerësimit të fushave të veprimtarisë administrative dhe fushave të funksioneve kryesore që Bashkia gëzon sipas ligjit. Më konkretisht, gjatë procesit u vlerësua:

- Fusha e menaxhimit finansiar;
- Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore, duke përfshirë edhe zbatimin e legjisacionit për parandalimin e konfliktit të interesit dhe për të drejtën e informimit dhe njoftimit e konsultimit publik;
- Fusha e kontrollit, auditimit dhe e mekanizmave kundër korrupzionit që përfshin edhe zbatimin e legjisacionit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve;
- Fusha e shërbimeve publike;
- Fusha e administrimit dhe menaxhimit të pronave;
- Fusha e planifikimit, administrimit dhe zhvillimit të territorit dhe
- Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve e të informacionit, si dhe të dokumenteve elektronike.

Vlerësimi u zhvillua nga një Grup Pune i ngritur nga Kryetari i Bashkisë ku bënин pjesë përfaqësues të administratës së bashkisë nën drejtimin e ekspertëve të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim gjatë periudhës mars-qershor 2024.

Hartimi i Planit të Integritetit në Bashkinë Fushë-Arrëz kaloi në fazat e mëposhtme:

Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore:

Hapi i parë i procesit të hartimit të Planit të Integritetit konsiston në ngritjen e grupit të punës me përfaqësues nga administrata dhe nga nëpunës të fushave kryesore të funksioneve të bashkisë.

Identifikimi dhe analizimi risqeve të integritetit:

Grupi i punës ka shqyrtuar kornizën rregullatore, strategjike si dhe dokumente të ndryshme operative të bashkisë.

Në këtë fazë, punonjësit e administratës kanë plotësuar një pyetësor në mënyrë anonime, në formë elektronike për të siguruar të dhëna dhe informacione për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të integritetit.

Vlerësimi i risqeve të integritetit:

Risqet e identikuara u vlerësuan në lidhje me:

- * mundësinë e ndodhjes së një ngjarjeje të padëshiruar kur nuk ka aktivitete kontrolli ose kur ato janë të pamjaftueshme për të parandaluar apo ulur riskun;
- * pasojën që një ngjarje e padëshiruar do të kishte në bashki nëse do të ndodhë.

Mundësia e ndodhjes së riskut dhe ndikimi i tij, u nda në tre kategori vlerësimi: i lartë/i moderuar/ i ulët dhe u renditën sipas prioritetit.

Plani i masave për menaxhimin e integritetit:

Identifikimit dhe vlerësimi i risqeve të integritetit shërben për vetëdijësimin e stafit për problematikat e hasura gjatë ushtrimit të punës së tyre.

Në përfundim të fazës së renditjes së risqeve sipas prioriteteve Grupi i Punës diskutoi mbi hartimin e një plani me masa konkrete për adresimin e risqeve të evidentuara. Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identikuara sipas fushave të përgjegjësisë së bashkisë Fushë-Arrëz, afatet kohore dhe personat përgjegjës. Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional.

Plani i Integritetit do të fillojë zbatimin pas miratimit nga Këshilli Bashkiak.

Hartimi i Planit të Integritetit realizohet në përputhje me metodologjinë për vlerësimin e riskut në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe përdor një qasje metodologjike cilësore dhe sasiore.

Objektivat e identikuara dhe niveli i përgjithshëm i ceneshmërisë së integritetit:

- ✓ Forcimi i kuadrit të brendshëm rregulator dhe transparencë;
- ✓ Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit;
- ✓ Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë.

Plani i Veprimit

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identikuara sipas fushave të përgjegjësisë së bashkisë Fushë-Arrëz. Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional.

Monitorimi dhe raportimi i Planit të Veprimit është periodik (çdo vit) dhe pasqyron kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës për zbatimin e masave të miratuara në të.

Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë eficente, nëse kanë nxjerrë në pah ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të

kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioriteteve të risqeve (planit të veprimit), si edhe nxjerrjen e mësimeve pér planifikim më të mirë në të ardhmen.

Bashkia i raporton çdo vit AMVV mbi procesin e vet të zbatimit të Planit të Integritetit dhe procesin e monitorimit.

Aldi Lepuri, duke ju falenderuar pér vëmendjen tuaj, mirëpresim sugjerimet dhe mendimin tuaj pér këtë projekt-plan.

Hil Curri, Kryetar i Bashkisë Fushë-Arrëz:

Gjatë diskutimit të tij i mëshon faktit që punonjësit e administratës duhet të jenë në një shkallë të lartë komunikimi qoftë me publikun ashtu edhe me njëri tjetrin. Etika në sjellje komunikim dhe veshje është një element shumë i rëndësishëm pér të rritë performancën e secilit në punë.

Rritja e performancës në punë është domosdoshmëri pér rritjen e performancës se Institucionit.

Sa i përket forcimit të kuadrit të brendshëm rregulator dhe transparencës në gjashtëmujorin e parë 2025 do të caktohet autoriteti përgjegjës pér parandalimin e konfliktit të interesave në bashki dhe njëkohësisht do të informohet stafi i bashkisë në lidhje me autoritetin përgjegjës dhe detyrat e tij.

Gjithashtu pér gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025 Koordinatori pér të Drejtën e Informimit/Grupi Punës ka detyrën të bëjë miratimin dhe publikimin e Programit të Transparencës së bashkisë në përputhje me udhëzimet e Komisionerit pér të Drejtën e Informimit dhe legjislacionin përkatës. Do të bëhet gjithashtu edhe përditësimi i vazhdueshëm i Programit të Transparencës me informacionin e nevojshëm.

Sa i përket menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki, pér identifikimin dhe parandalimin risqeve të integritetit, Burimet Njerëzore/Financa pér gjatë gjashtëmujorit të dytë 2025, do të alokojnë një një zë të posacëm buxhetor pér mbulimin e kostove të trajnimeve dhe certifikimeve profesionale pér punonjësit e bashkisë.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, Bashkia do të bëjë analizën e kapaciteteve ekzistuesve dhe hartimi sipas prioritetave i planifikimit pér shtimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike.

Hil Curri, Kryetar i Bashkisë Fushë-Arrëz:

Ne do t'i referohemi Planit të Integritetit sipas tabelës në projekt, në mënyrë që të normalizojmë të gjithë opsonet e risqeve që mund të cënojnë Integritetin e bashkisë tonë.

Pashk Prendi, përgëzon drejtuesit dhe panelin pér dëgjesën publike dhe njëkohësisht kërkon që herë të tjera në dëgjesa të tillë të shpërndahen në publik material fizik në letër nga projektet, pavarësisht se ato janë të publikuara ne websitin zyurtar të bashkisë.







Naze Selimaj, Sekretar i Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, meqë nuk ka diskutime apo pyetje nga publiku, takimi mbylljet këtu duke falenderuar të gjithë të pranishmit!

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

A handwritten signature of Naze Selimaj is positioned to the left of a circular blue ink stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISË' at the top and 'MUNICIPALITETI I FUSHË-ARRËZ-ES' around the bottom edge. In the center of the stamp is the national emblem of Albania, featuring an eagle with wings spread, perched on a shield.